

# BORDET E POLITIKËS

PRISHTINË – QERSHOR 2021





# BORDET E POLITIKËS

PRISHTINË – QERSHOR 2021

COPYRIGHT © 2021. Kosova Democratic Institute (KDI).Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi,  
Nr. 239,10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

**Autor:** Verolinda Berisha

# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b> .....	<b>7</b>
<b>DALLIMET NDËRMJET NDËRMARRJEVE PUBLIKE QENDRORE DHE LOKALE</b> .....	<b>9</b>
<b>AKSIONARËT</b> .....	<b>10</b>
<b>BORDI DREJTUES I NDËRMARRJES PUBLIKE QENDRORE</b> .....	<b>11</b>
<b>PËRZGJEDHJA E DREJTORËVE TË BORDEVE</b> .....	<b>13</b>
<b>KRITERET E KUALIFIKIMIT</b> .....	<b>14</b>
<b>BORDET E PËRKOSSHME TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE</b> .....	<b>18</b>
<b>CILAT JANË PRAKTIKAT NË NDËRMARRJET PUBLIKE NË KOSOVË</b> .....	<b>18</b>
EMËRIMET PARTIAKE NË NDËRMARRJET PUBLIKE PRAKTIKAT E GJETURA.....	19
MOSRESPEKTIMI I PROCEDURAVE GJATË EMËRIMIT .....	21
MOSDEKLARIMI I PASURISË NGA DREJTORËT E BORDEVE.....	24
SHPËRPTHJA GJINORE NË BORDE.....	26
TRANSPARENCA E PUNËS NË NDËRMARRJET PUBLIKE .....	27
<b>REKOMANDIMET</b> .....	<b>22</b>



# SHKURTESAT:

- KDI** Instituti Demokratik i Kosovës
- TI** Transparency International
- Qeveria** Qeveria e Republikës së Kosovës
- NPQ** Ndërmarrjet Publike Qendrore
- NPL** Ndërmarrjet Publike Lokale
- Ligji** Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe plotësim ndryshimet e tij
- OJQ** Organizata joqeveritare
- Kuvendi** Kuvendi i Republikës së Kosovës



# HYRJE

Ky raport trajton disa nga sfidat me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet publike qendrore në Kosovë, me theks të veçantë në mënyrat se si Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore përzgjidhen dhe operojnë. Me qëllim të kuptimit të këtyre sfidave është analizuar Ligji aktual për ndërmarrjet publike dhe udhëzimet administrative që derivojnë prej saj, vendimet e Qeverisë, raportet e organizatave joqeveritare si dhe raportimet nga mediat e shkruara në Kosovë.

Gjatë analizës së procedurave ligjore për përzgjedhjen e drejtorëve të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore jemi fokusuar në identifikimin e mangësive ligjore, rasteve të mosrespektimit të dispozitave ligjore gjatë përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore, rasteve të mosdeklarimit të pasurisë nga drejtorët e bordeve dhe mungesës së transparencës së punës së këtyre bordeve.

Bordet e analizuar në këtë studim janë ato që udhëhoqën ndërmarrjet publike qendrore gjatë vitit 2020, si Korporata Elektroenergjetike e Kosovës, Posta e Kosovës, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Trainkos, Infra-kos, Kompania për Menaxhimin e Deponive, NPH Ibër- Lepenc dhe Trepça.

Në fund analiza jep disa rekomandime konkrete me qëllim të përmirësimit të gjendjes së sektorin e ndërmarrjeve publike.



Me qëllim të kuptimit të këtyre sfidave është analizuar **Ligji aktual për ndërmarrjet publike dhe udhëzimet administrative që derivojnë prej saj, vendimet e Qeverisë, raportet e organizatave joqeveritare si dhe raportimet nga mediat e shkruara në Kosovë.**



# FUNKSIONIMI I NDËRMARRJEVE PUBLIKE NË KOSOVË

Nga shpallja e pavarësisë, Kosova ka filluar procesin e ndërtimit të institucioneve shtetërore funksionale dhe demokratike. Kosova është Republikë parlamentare, udhëheqja e së cilës bazohet në parimin e ndarjes së pushteteve. Qeverisja parlamentare e Kosovës ushtrohet nga Kuvendi i Kosovës, prej të cilit derivon pushteti ekzekutiv që ushtrohet nga Qeveria e Kosovës. Kuvendi zgjedh edhe Presidentin e Kosovës, i cili përfaqëson unitetin e popullit.

Kosova, si shtet i ri, është ende në procesin e ndërtimit të strukturave dhe institucioneve qeverisëse të qëndrueshme dhe transparente. Korrupsioni vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore për arritjen e zhvillimit të nevojshëm dhe kusht për procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian apo liberalizimin e vizave. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (CPI) nga Transparency International<sup>1</sup> për vitin 2020 e renditi Kosovën në pozitën e 104, me vetëm 36 pikë. Rezultatet e pandryshuara të këtij Indeksi vite me radhë, e konfirmojnë stagnimin në luftën kundër korrupsionit dhe dështimin e institucioneve për adresimin e tij.

Tiparet e stagnimit të shtetit janë prezente edhe tek ndërmarrjet publike në Kosovë, të cilat funksionojnë në kuadër të Qeverisë së Kosovës apo Komunave, varësisht se kush është përgjegjës për to. Shërbimet të cilat ofrohen nga ndërmarrjet publike prekin interesin e gjerë shoqëror dhe ndikojnë në kualitetin e jetës së qytetarëve. Qëllimi i funksionimit të këtyre ndërmarrjeve është ofrimi i shërbimeve publike që plotësojnë kërkesat dhe nevojat e përditshme të qytetarëve

të një shteti, duke filluar prej furnizimit me ujë, energji elektrike, transport publik, mbledhjen e mbeturinave, pastrimin e rrugëve, etj.

Ndërmarrjet publike në Kosovë janë rregulluar me ligj të veçantë dhe pronësia e tyre është e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Sipas nenit 160 të Kushtetutës, të gjitha ndërmarrjet publike janë në pronësi të Kosovës. Ky nen po ashtu lejon edhe të drejtën e komunave në pronësinë e ndërmarrjeve të cilat ofrojnë shërbime vetëm në komuna të caktuara.<sup>2</sup>

Në vitin 2008 Kosova miratoi Ligjin për Ndërmarrjet Publike, qëllimi i të cilit ishte të rregullojë organizimin e ndërmarrjeve publike në Kosovë, udhëheqjen dhe funksionimin e tyre. Sipas këtij ligji, ndërmarrjet publike në Kosovë organizohen si shoqëri tregtare në bazë të Ligji për Shoqëritë Tregtare në krye të të cilave gjenden bordet drejtuese, ndërsa varësisht nga pronari, ato ndahen në nivel lokal dhe nivel qendror. Për shkak të kërkesave të kohës, problemeve të shfaqura gjatë menaxhimit të ndërmarrjeve si dhe rekomandimeve nga aktorët institucional dhe jashtëinstitucional, Kuvendi i Kosovës me propozim të Qeverisë e ka plotësuar dhe e ka ndryshuar dy herë këtë ligj në vitin 2012<sup>3</sup> dhe më 2015.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> [https://images.transparencycdn.org/images/CPI2020\\_Report\\_EN\\_0802-WEB-1\\_2021-02-08-103053.pdf](https://images.transparencycdn.org/images/CPI2020_Report_EN_0802-WEB-1_2021-02-08-103053.pdf)

<sup>2</sup> Kushtetua e Kosovës, Neni 160 [https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se\\_Kosoves-2.pdf](https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_Kosoves-2.pdf)

<sup>3</sup> Ligji Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>

<sup>4</sup> Ligji Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe i Plotësuar më Ligjin Nr. 04/L-111 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10822>







# DALLIMET NDËRMJET NDËRMARRJEVE PUBLIKE QENDRORE DHE ATYRE LOKALE

Ndërmarrjet publike në Kosovë ndahen në ndërmarrje publike qendrore dhe lokale. Dallimi thelbësor ndërmjet tyre qëndron tek pronari. Ndërmarrjet publike qendrore janë në pronësi të Republikës së Kosovës dhe kompetente për to është Qeveria, ndërsa ndërmarrjet publike lokale janë në pronësi të komunës ose komunave, varësisht se si është e përcaktuar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.<sup>5</sup>

Dallimi tjetër në mes të këtyre ndërmarrjeve qëndron në atë se ndërmarrjet publike qendrore ofrojnë shërbime publike për të gjithë qytetarët e Kosovës, ndërsa ndërmarrjet publike lokale ofrojnë shërbime vetëm për banorët e komunës ose komunave në pronësinë e të cilave janë.

Përbërja e Bordit të Drejtorëve përkatësisht numri i tyre është një dallim tjetër në mes të ndërmarrjeve qendrore dhe lokale. Përderisa bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve publike qendrore përbëhen prej 5 ose 7 anëtarëve, ai i ndërmarrjeve publike lokale përbëhet prej 5 anëtarëve.

E përbashkëta e këtyre Bordeve qëndron në mandatin e tyre, i cili zgjatë 3 vjet.

Ligji për ndërmarrjet publike përmban listat e ndërmarrjeve publike qendrore dhe atyre lokale. Të përcaktuara me ligj janë: Korporata Elektroenergjetike e Kosovës Sh.A (KEK),

Operatori i Sistemit Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK), Hekurudhat e Kosovës dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës. Kurse, prej NP-ve Lokale të përcaktuara me ligj janë: Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A-Prishtinë, Ngrohtorja e Qytetit Gjakova Sh.A-Gjakovë, Kompania Rajonale e Mbeturinave Çabradi Sh.A-Gjakovë, Kompania e Mbeturinave JKP Standard-Mitrovicë, Kompania Rajonale e Mbeturinave Ambienti Sh.A-Pejë.<sup>6</sup> Qeveria e Kosovës është e autorizuar dhe e detyruar të bëjë ndryshime të këtyre listave në rastet kur këto ndryshime janë të nevojshme. Përgjatë viteve Qeveria por edhe Komunitat kanë themeluar ndërmarrje të reja, në varësi të punëve dhe nevojave që ato kishin.



Përderisa bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve publike qendrore përbëhen prej 5 ose 7 anëtarëve, ai i ndërmarrjeve publike lokale përbëhet prej 5 anëtarëve.

<sup>5</sup> Ligji për Ndërmarrjet Publike, neni 3 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>

<sup>6</sup> Listat e ndërmarrjeve publike qendrore dhe lokale janë të përcaktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>





# AKSIONARËT

Ndërmarrjet publike në Kosovë organizohen si shoqëri aksionare në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Sipas këtij ligji, shoqëria aksionare është një person juridik i cili është në pronësi të aksionarëve<sup>7</sup>. Aksionet në shoqëri aksionare shërbejnë për përcaktimin e interesave dhe të drejtave pronësore të aksionareve. Pra, aksionet janë një-sia në bazë të së cilës ndahen të drejtat e aksionareve në pronësinë e shoqërisë aksionare.

Sipas ligjit, të gjithë aksionarët e një ndërmarrjeje janë të barabartë sa i përket të drejtave dhe detyrimeve të tyre. Bordi i drejtorëve është i detyruar të siguroj që të gjithë aksionarët e ndërmarrjes trajtohen në mënyrë të barabartë. Ky obligim ligjor i Bordit është shumë i rëndësishëm sidomos për ndërmarrjet publike lokale të cilat mund të jenë në bashkëpronësi të disa komunave ose në rastet kur aksionet e ndërmarrjeve publike qendrore shiten pjesërisht dhe kemi edhe aksionarë tjerë përpos Qeverisë së Kosovës.<sup>8</sup>

Aksionarët e ndërmarrjes kanë **rol mbikëqyrës** në punën e Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimeve të ndërmarrjes së caktuar. Kjo mbikëqyrje, sipas ligjit duhet të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe rigoroze. Sipas Ligjit për NP-të, bordet drejtuese në baza vjetore bëjnë vlerësime sistematike të punës së tyre dhe përgatisin raporte tre mujore dhe vjetore mbi aktivitetet e tyre dhe efektshmërinë e punës së tyre (neni 28, 29, 31). Mirëpo, me ligj aksionarët kanë të drejtë të kërkojnë çdo herë raport të punës kur vërehen se performanca e ndërmarrjes është e dobët ose nuk është në përputhje me objektivat dhe planin e ndërmarrjes.

Aksionarët gjithashtu kanë edhe **rol raportues**. Qeveria e Kosovës si aksionar i ndërmarrjeve qendrore, ligjërisht është e detyruar të raportoj në Kuvendin e Kosovës mbi punën e saj.


Çdo vit Qeveria përkatësisht Komisioni Komunal i Aksionarëve, përgatisin një raport vjetor për Kuvendin e Kosovës, respektivisht Kuvendet Komunale, në lidhje me ushtrimin e kompetencave dhe autorizimeve si aksionar i ndërmarrjeve.

Shitja e aksioneve është e rregulluar me nenin 9 të Ligjit për Ndërmarrje Publike. Qeveria si aksionar, mund të vendos që t'i shes të gjitha apo një pjesë të aksioneve të ndonjë ndërmarrjeje publike. Për çdo shitje të aksioneve Qeveria duhet të marr miratimin e Kuvendit, i cili përmes votave të shumicës vendos për shitjen apo refuzon shitjen e aksioneve në një ndërmarrje.

<sup>7</sup> Ligji për shoqëritë tregtare, neni 118 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16426>

<sup>8</sup> Shiko nenin 12 paragrafi 3 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16426>





# BORDI DREJTUES I NDËRMARRJES PUBLIKE QENDRORE

Bordevë u është besuar operimi dhe udhëheqja me ndërmarrjet<sup>9</sup>. Gjatë analizimit të ligjit vërehet se kompetencat dhe detyrat e bordit janë të shpërndara në shumë nene, gjë që nuk ndihmon aspak publikun të kuptoj saktë se cilat janë në të vërtetë kompetencat dhe detyrat e bordevë.

**Detyrat e përgjithshme të drejtorëve të Bordevë janë të përcaktuara me nenin 12 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe të cilat janë si në vijim:**

- 
- (A) ushtrimi i veprimtarisë me qëllim të rritjes afatgjate të vlerës së ndërmarrjes dhe aksionarëve të saj;
- 
- (B) ushtrimi i detyrave në përputhje me strategjitë afariste dhe financiare të përshkuara në Planin e miratuar të Biznesit të ndërmarrjes,
- 
- (C) trajtimi i aksionarëve në mënyrë të barabartë dhe
- 
- (D) ushtrimi i rregullt i detyrave të tyre si drejtor.<sup>10</sup>
- 

Ky nen definon kompetencat dhe detyrat e bordit, por pa e rregulluar tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga vet ligji. Shpërndarja e të drejtave dhe detyrimeve të bordit nëpër nene të ndryshme krijon mundësinë e shfrytëzimit të mangësive ligjore nga ana e anëtarëve të bordit në dëm të ndërmarrjes publike.

<sup>9</sup> Ligji për Ndërmarrjet Publike, Neni 15 paragrafi 1 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>

<sup>10</sup> Shiko nenin 12 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>



Bordi i drejtorëve është përgjegjës për emërimin e zyrtarëve të ndërmarrjes dhe mbikëqyrjen e punës së tyre si dhe ka kompetenca për shkarkimin e tyre. Madje, ligji përcakton së kjo ndërprerje mund të bëhet edhe **për mungesë të deklarimit të arsyes së ndërprerjes së kontratës**.<sup>11</sup> Një dispozitë e tillë ligjore shkakton pasiguri tek zyrtarët e punësuar në ndërmarrje dhe është **në kundërshtim me Ligjin e Punës**. Sipas Ligjit të Punës, punëdhënësi është i detyruar të mbajë takim me të punësuarin me qëllim që t'ia shpjegoj ndërprerjen e kontratës së punës.<sup>12</sup>

Një ndërmarrje publike funksionon në bazë të Planit të Biznesit të ndërmarrjes. Ky plan miratohet nga Bordi, i cili përcjellë performancën e ndërmarrjes me qëllim të mos devijimit nga objektivat e ndërmarrjes të përcaktuara më këtë plan. Nëse Bordi gjen se performanca e ndërmarrjes ka devijuar nga synimet afariste dhe ekonomike të përcaktuara me Planin e Biznesit, atëherë kërkon llogari prej drejtorit ekzekutiv të ndërmarrjes për shkaqet e devijimit.

Përveç vlerësimit dhe mbikëqyrjes së punës së zyrtarëve të ndërmarrjes, Bordi është i detyruar gjithashtu të vlerësoj punën e vet, vlerësim ky i cili bëhet në mënyrë sistematike. Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të kryer vlerësimin, i cili duhet të kryhet në kohë dhe në mënyrë të rregullt. Qëllimi i këtij vlerësimi është që bordi të analizojë dhe të dokumentojë punën e përgjithshme të kryer brenda vitit raportues. Përveç vlerësimit të përgjithshëm të performancës, bordi analizon punën e anëtarëve individual të tij. Pra, pjesë e këtij vlerësimi është vlerësimi i aftësive, përvojës dhe kualifikimit profesional të anëtarëve të bordit dhe analizimi i kontributit dhe efektshmërisë që ata sjellin tek performanca e përgjithshme e bordit. Ky vlerësim ka për qëllim që të nxjerr në pah sesa i efektshëm është bordi në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij.<sup>13</sup>

Pra, siç shihet bordi udhëheqës ka një rëndësi shumë të madhe për mirëfunksionimin e ndërmarrjes, ndaj puna e tyre ndikon direkt në jetën e qytetarëve dhe të shërbimeve publike, të cilat i marrin ata.



Nëse Bordi gjen se performanca e ndërmarrjes ka devijuar nga synimet afariste dhe ekonomike të përcaktuara me Planin e Biznesit, **atëherë kërkon llogari prej drejtorit ekzekutiv të ndërmarrjes për shkaqet e devijimit.**

11 Ligji për Ndërmarrjet Publike, Neni 21 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>

12 Ligji i Punës, neni 70 paragrafi 3 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>

13 Shiko nenin 28 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16426>

# PËRZGJEDHJA E DREJTORËVE TË BORDEVE

Dallimi në mes **përzgjedhjes** dhe **emërimit** të anëtarëve qëndron te procedura që ndiqet nga Qeveria. Procedura për përzgjedhjen e anëtarëve zakonisht fillohet më hapjen e një konkursi publik dhe me përcaktimin e kriterëve e nevojshme për t'u kualifikuar për pozitën e kërkuar. Pastaj, në mesin e personave që kanë kandiduar për pozitën e lirë, përzgjidhet personi, i cili konsiderohet se i përmbush kriteret e kërkuara. Ndërsa, te procesi i emërimit nuk aplikohet konkursi, por akcionari e identifikon kandidatin më të përshtatshëm për vendin e lirë, ndaj atij/asaj i ofrohet puna.

Procedura e përzgjedhjes së Drejtorëve rregullohet me Ligjin për Ndërmarrje Publike.<sup>14</sup> Sipas këtij ligji, të gjithë drejtorët përzgjidhen nga Qeveria e Kosovës, procedurë e cila shpesh ka qenë objekt i kritikave për mungesë transparence dhe shmangie të praktikës së konkursit publik.<sup>15</sup>

Respektimi i plotë i dispozitave ligjore dhe proceduarave nënkupton që Qeveria duhet t'i ndjek këta hapa:

① Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë përmes një vendimi emëron një Komision Rekomandues, detyra e të cilit është t'i identifikoj dhe t'i rekomandoj Qeverisë kandidatët potencial për pozitën e drejtorit në Bordin e NP-ve. Sekretari në këtë komision duhet të caktojë 7 anëtarë për t'i identifikuar kandidatët potencial të bordit drejtues. Sipas ligjit, anëtarë të Komisionit Rekomandues mund të emërohen vetëm shërbyes të lartë civil ose ekspertë të jashtëm me kusht që të jenë kuali-

fikuar dhe me përvojë nga industria përkatëse, financat apo qeverisja korporative.

- ② Njëkohësisht Qeveria hap konkursin publik për pozitën në bordet e ndërmarrjeve publike, në të cilin duhet të përshkruhen qartë edhe kriteret e kërkuara për pozitën e hapura.
- ③ Pas përfundimit të afatit të pranimit të dokumentacionit dhe aplikimit, mblidhet Komisioni Rekomandues, i cili e ka për obligim ta verifikoj nëse aplikimet i kanë përmbushur kriteret e kërkuara. Pas listimit të personave që e kanë kaluar fazën e parë, Komisioni Rekomandues e bën intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve.
- ④ Komisioni pas intervistave dhe vlerësimeve përgatit një listë të kandidatëve, të cilët marrin vlerësim pozitiv. Kjo listë më pas i dërgohet Qeverisë me rezultatet e arritura nga secili kandidat.
- ⑤ Qeveria, pas marrjes së listës së kandidatëve nga Komisioni Rekomandues, i përzgjedh anëtarët e Bordit.

Pra, e gjithë procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të bordeve fillon dhe mbaron brenda vetë Qeverisë. Rrjedhimisht një pjesë e madhe e përgjegjësisë për përzgjedhjen e këtyre Bordeve i takon Komisionit Rekomandues. Kjo mënyrë e përzgjedhjes së anëtarëve të Bordeve krijon hapësirë për keqpërdorime dhe hapësirë që përzgjedhjet nga ana e Komisionit Rekomandues.

<sup>14</sup> Shiko nenin 15 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>

<sup>15</sup> QEVERISJA KORPORATIVE NË NDËRMARRJET PUBLIKE NË KOSOVË. Përmirësimi i transparencës dhe qeverisjes së fondeve publike në Kosovë, RIINVEST INSTITUTE, 2012. I qasur me datë 24.06.2021. <https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/alb-u1476694068.pdf>



dues të jenë të ndikuara politikisht dhe t'i favorizojnë partitë në pushtet<sup>16</sup>.

Ligji përcakton se anëtarë të Komisionit Rekomandues duhet të emërohen vetëm shërbyesit e lartë civil ose ekspertë të jashtëm me kualifikime të larta dhe me përvojë nga industria përkatëse, përvojë në financa ose qeverisja korporative. Po ashtu, nuk mund të emërohet më shumë se një person nga një autoritet publik ose institucion i caktuar edhe në rastet kur një ministri ka rol udhëheqës të politikbërjes në sektorin në të cilin NP-ja e ushtron veprimtarinë e saj. Në këtë rast, duhet të emërohet një person nga ajo ministri.<sup>17</sup>

Gjatë përzgjedhjes së këtyre Bordeve është e obligueshme të zbatohen dispozitat ligjore në lidhje me respektimin e komuniteteve jo shumicë në Kosovë si dhe kriterit të barazisë gjinore. Ligji për Ndërmarrjet Publike kërkon që njëri prej drejtoreshave të zgjedhur t'i përkasë komunitetit jo shumicë<sup>18</sup> dhe se përbërja e Bordeve të ndërmarrjeve duhet të jetë në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore<sup>19</sup>.

Përfaqësimi i grave në udhëheqjen e Ndërmarrjeve Publike Qendrore, vazhdon të mbetet në nivel të ulët, përkundër obligimeve që dalin nga Ligji për Barazinë Gjinore<sup>20</sup>. Sipas Ligjit për Barazinë Gjinore, organet shtetërore dhe institucionet publike janë obliguara të marrin masa për të siguruar përfaqësim të barabartë gjinor, i cili arrihet kur kemi një përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini.<sup>21</sup> Plotësim ndryshimi i fundit në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, obligon që në përbërjen e bordeve të drejtorëve të vendosen gra, sipas kërkesave ligjore nga Ligji për barazi gjinore.<sup>22</sup>

Udhëheqja e ndërmarrjeve publike qendrore të Kosovës dominohet nga burrat<sup>23</sup>. Në shumicën e Bordeve kemi vetëm

një ose dy gra në pozitat e drejtorëve të bordit, ndërkohë që shumë shpesh ka pasur raste kur Qeveria në borde nuk e ka emëruar asnjë grua. Ky dominim i burrave dhe mos përpjekjet e Qeverisë për arritjen e një përfaqësimi të barabartë gjinor në udhëheqje minojnë vlerat themelore demokratike për barazi e drejtësi.

Problem pas përzgjedhjes apo emërimit të Bordit të Drejtorëve është vërejtur te deklarimi i pasurisë nga Drejtorët e Bordit. Deklarimi i pasurisë të zyrtarëve të lartë publik është një nga instrumentet për parandalimin e korrupsionit dhe zbulimin e pasurimit të kundërligjshëm të zyrtarëve publik. Deklarimi i pasurisë së zyrtarëve publik në Kosovë rregullohet me Ligjin për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publikë<sup>24</sup>. Sipas këtij ligji, deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë publik është një detyrim ligjor, mosrespektimi i të cilit rezulton në kryerjen e veprës të kundërvajtjes e që në rast se zbulohet se vepra është kryer, atëherë kryesi do ta marr sanksionin e paraparë me ligj.

Zyrtarët e lartë publik sipas Ligjit për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publikë janë të detyruar të deklarojnë pasurinë e tyre ekzistuese pas marrjes së detyrës. Ligji për deklarimin e pasurisë ju jep një afat prej tridhjetë (30) ditësh për ta deklaruar tek Agjencia Kundër Korrupsionit pasurinë tyre<sup>25</sup>. Në rast të shkeljes së kësaj dispozite dhe mosrespektimit të këtij obligimi ligjor, zyrtari i lartë publik kryen kundërvajtje dhe dënohet me gjobë prej një mijë (1000) deri dymijë e pesëqind (2500) euro.<sup>26</sup>

16 QEVERISJA KORPORATIVE NË NDËRMARRJET PUBLIKE NË KOSOVË. Përmirësimi i transparencës dhe qeverisjes së fondeve publike në Kosovë, RIINVEST INSTITUTE, 2012. I qasur me date 24.06.2021. <https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/alb-u1476694068.pdf>

17 Ligji për Ndërmarrjet Publike, Neni 15.2 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>

18 Ligji Nr. 04/L-111 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Neni 8 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2822>

19 Ligji Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe i Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Neni 6 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10822>

Shiko Ligjin për Barazi Gjinore, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

20 Ligji për NP, neni 6 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10822>

21 Ligji për Barazinë Gjinore, Neni 6, paragrafi 7 dhe 8 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

22 Shiko neni 17.4a i ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr.04/L-111

23 <https://kallxo.com/lajm/bordet-e-ndermarrjeve-publike-te-rezervuara-per-burra/>

24 Ligjin për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publik <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767>

25 Ligjin për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publik, Neni 7 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767>

26 Ligjin për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publik, Neni 17 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767>



# KRITERET E KUALIFIKIMIT

Rëndësia dhe roli që kanë drejtorët e bordeve në udhëheqjen e ndërmarrjeve e bën të domosdoshëm plotësimin e kriterëve dhe kushteve nga kandidatët në mënyrë që ata t'i ushtrjnë këto detyra. Kriteri i detyrueshëm për t'u plotësuar është profesionalizmi i anëtarëve të bordeve. Sipas nenit 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, për të arritur profesionalizëm në udhëheqje dhe mirëfunksionim të ndërmarrjes, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- (A) 5 vite përvojë pune në një nivel të lartë të menaxhmentit,
- (B) së paku 5 vite përvojë pune si kontabilist publik, jurist i kualifikuar ose
- (C) anëtar i kualifikuar i ndonjë profesioni tjetër, i cili ndërlihet ngushtë me veprimtarinë e ndërmarrjes.

Është e nevojshme që personi i përzgjedhur të ketë integritet. Integriteti në punë është një faktor i rëndësishëm për qeverisje profesionale, ku përfshihen disa tipare të karakterit si: ndershmëria, besueshmëria, transparenca dhe etika në punë. Mbi të gjitha integriteti përfshinë aftësinë për të gjykuar në mënyrë të "shëndoshë" situatat e ndryshme, persona që dinë të marrin vendime të drejta dhe të duhura e gjithashtu persona të cilët janë të besueshëm dhe të parashikueshëm në marrëdhëniet me të tjerët.<sup>27</sup>

Përzgjedhja e bordeve me persona me integritet ndikon në krijimin e besimit të qytetareve tek udhëheqjen e këtyre bordeve. Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, integriteti mund të provohet me një të kaluar të pastër ligjore, me kushtin që drejtorët e bordeve të mos kenë qenë të dënuar për ndonjë

vepër penale ose civile nga ndonjë gjykatë, vepra këto që përfshijnë: mashtrimin, korrupsionin, vjedhjen, pastrimin e parave dhe ryshfetin.<sup>28</sup> Prandaj, jo rastësisht integriteti është kriter i kërkuar ligjërisht prej individëve, të cilëve u është besuar qeverisja me ndërmarrje të tilla, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në jetën e përditshme të qytetarit të Kosovës.

Paragrafi 2 i nenit 17 i Ligjit për Ndërmarrje Publike kërkon që anëtarët e bordeve të jenë të pavarur. Sipas këtij ligji, pavarësia është interpretuar në forma dhe situata të ndryshme duke përmendur të gjitha rastet të cilat mund ta cenojnë pavarësinë dhe neutralitetin e udhëheqjes së bordeve. Zyrtarët, menaxherët, punonjësit aktual apo ata që kanë pasur këtë pozitë gjatë viteve të fundit (periudha është e përcaktuar me ligji dhe ndryshon varësisht nga pozita)<sup>29</sup> nuk e konsiderohen të pavarur, ndaj rrjedhimisht nuk mund të përzgjidhen drejtorë bordesh.

Janë të rëndësishme **pikat k dhe l** të nenit 17, paragrafi 2. Në pikën **k** të këtij neni kërkohet pavarësi politike e anëtarëve të bordit. Ligji e ndalon që të përzgjidhet drejtor bordi kushdo, i cili gjatë periudhës prej 36 muaj para datës së aplikimit ka qenë "(i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike".

Mirëpo "vendosja e personave politik në krye të bordeve të ndërmarrjeve publike ndodh për shkak të dy interesave madhore të partive politike. Nga njëra anë, mundësia për të sistemuar anëtarë dhe përfaqësues të lartë të partisë në këto pozita të larta, shërben si joshje apo shpërblim nga partia për anëtarët e saj. Kjo krijon mundësinë për t'i përforcuar

<sup>27</sup> <https://aabri.com/manuscripts/10504.pdf>

<sup>28</sup> KDI, Vlerësimi i Sistemit të Integritetit Kombëtar, 2015, fq.240 [https://kdi-kosova.org/ep-content/uploads/publikime/71-kdi-nis-alb\\_all\\_single\\_final.pdf](https://kdi-kosova.org/ep-content/uploads/publikime/71-kdi-nis-alb_all_single_final.pdf)

<sup>29</sup> Sipas këtij neni, nuk mund të përzgjidhet drejtor bordi personi, i cili brenda 5 viteve të fundit ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i ndërmarrjes, i cili brenda 3 viteve të fundit ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë i ndërmarrjes, gjatë 3 viteve të fundit ka pasur marrëdhënie materiale afariste me ndërmarrjen, përveç në rastet kur ka qenë konsumator individual i shërbimeve të cilat i ofron ndërmarrja.



radhët e partisë. Për më tepër, kur këta persona emërohen, atyre u jepet fuqia që të punësojnë persona të politizuar në pozita më të ulëta në një ndërmarrje, duke i dhënë një shtytje më shumë partisë. Nga ana tjetër, vendosja e anëtarëve të partisë në borde drejtuese të ndërmarrjeve publike i jep fuqi partive politike që të ndikojnë në këtë ndërmarrje për t'i shty përpara politikat e tyre.”<sup>30</sup>

Ligji nuk e rregullon situatën kur drejtor bordi emërohet një person, i cili është anëtar i një partie politike. Ka shumë raste kur kandidatët për deputetë të Kuvendit të Kosovës ose kandidatët për kryetarë komunash nga radhët e partive politike në pushtet, të cilët nuk i kanë marrë votat e mjaftueshme për atë pozitë, përgjithësisht drejtorë bordesh nga partitë, të cilave u përkasin.

Nga ana tjetër, pika l e rregullon konfliktin e interesit. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, në ushtrimin e funksionit publik, konflikti i interesit definohet “rrethana në të cilën zyrtari ka interes private, e cila mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”<sup>31</sup>. Kurse sipas Transparency International, konflikti i interesit definohet si “situata kur një individ ose institucioni për të cilin ata punojnë, qoftë qeveri, biznes, media apo organizatë e shoqërisë civile, përballet me zgjedhjen midis detyrave dhe kërkesave të pozitës së tyre dhe interesave të tyre private”.<sup>32</sup>

Sipas kësaj, detyrën e drejtorit të bordit nuk mund ta ushtrojë një person, i cili ka çfarëdo konflikti të interesit dhe i cili do të ndikonte që ky person të mos mund t’ia ushtrojë në mënyrë rutinore, të pavarur, objektive dhe me besnikëri detyrat dhe obligimet e tij/saj ndaj ndërmarrjes. Konflikti i interesit ndikon në luhatjen e paanshmërisë dhe të qenit e subjektiv gjatë ushtrimit të detyrave.

Përkundër këtij rregullimi ligjor, bordet e ndërmarrjeve publike shpesh janë parë si të politizuara për shkak të emërimeve të shumta politike, nepotizmit të vazhdueshëm dhe mungesës së transparencës në përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve.<sup>33</sup> Si rezultat i kësaj, emërimet e tilla krijojnë hapësirë që bordet të mos i ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me objektivat e ndërmarrjes, mirëpo të veprojnë në bazë të pëlqimeve dhe interesave të partive politike, të cilat edhe i kanë sjellë në ato pozita.



Paragrafi 2 i nenit 17 i Ligjit për Ndërmarrje Publike kërkon që anëtarët e bordeve të jenë të pavarur. **Sipas këtij ligji, pavarësia është interpretuar në forma dhe situata të ndryshme duke përmendur të gjitha rastet të cilat mund ta cenojnë pavarësinë dhe neutralitetin e udhëheqjes së bordeve.**

30 Menaxhimi publik: Analizë e bordeve të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura, KIPRED, maj 2011, faqe 15, i qasur me datën 13 qershor 2021 në [http://kipred.org/repository/docs/Menaxhimi\\_Publik\\_-\\_Analiz%C3%AB\\_e\\_Borveve\\_t%C3%AB\\_Nd%C3%ABmarrjeve\\_Publike\\_dhe\\_Agjencive\\_t%C3%AB\\_Pavarura\\_\\_535599.pdf](http://kipred.org/repository/docs/Menaxhimi_Publik_-_Analiz%C3%AB_e_Borveve_t%C3%AB_Nd%C3%ABmarrjeve_Publike_dhe_Agjencive_t%C3%AB_Pavarura__535599.pdf)

31 Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik, Neni 6 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16314>

32 <https://transparency.org/en/corruptionary/conflict-of-interests>

33 KIPRED. Menaxhimi Publik: Analizë e bordeve të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura, 2012. I qasur me date 24.06.2021. [http://www.kipred.org/repository/docs/Menaxhimi\\_Publik\\_-\\_Analiz%C3%AB\\_e\\_Borveve\\_t%C3%AB\\_Nd%C3%ABmarrjeve\\_Publike\\_dhe\\_Agjencive\\_t%C3%AB\\_Pavarura\\_\\_535599.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Menaxhimi_Publik_-_Analiz%C3%AB_e_Borveve_t%C3%AB_Nd%C3%ABmarrjeve_Publike_dhe_Agjencive_t%C3%AB_Pavarura__535599.pdf)







# BORDET E PËRKOHSHME TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE

Ligji për Ndërmarrjet Publike mundëson krijimin e Bordeve të Përkohshme të Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike. Ky ligj autorizon Qeverinë e Kosovës të caktojë një Bord të Përkohshëm të Drejtorëve, i cili shërben si Bord i Drejtorëve deri në zgjedhjen e bordit të përhershëm.<sup>34</sup>

**Edhe pse te dy llojet e bordeve, ai i përhershëm dhe ai i përkohshëm, e ushtrojnë funksionin e udhëheqjes së Ndërmarrjes Publike, ekzistojnë disa dallime midis tyre.**

- 
- A** Dallimi i parë qëndron në faktin se Bordi i Përhershëm zgjidhet nga Qeveria e Kosovës me një procedurë të përcaktuar me Ligjin për Ndërmarrje Publike, ndërsa Bordi i Përkohshëm emërohet nga Qeveria.
- 
- B** Dallimi i dytë është në periudhën kohore gjatë së cilës shërben ky bord. Bordi i Përhershëm zgjidhet nga Qeveria me një mandat prej 3 vjetësh, ndërsa Bordi i Përkohshëm shërben për një periudhë prej gjashtë muajsh.
- 
- C** Dallim i tretë gjendet në numrin e anëtarëve të bordit, ku Bordi i Përhershëm përbëhet nga 5 ose 7 anëtarë, ndërsa Bordi i Përkohshëm përbëhet nga 5 anëtarë.
- 

Gjatë analizimit të emërimit të Bordeve të Përkohshme, KDI-ja ka identifikuar lëshime në zbatimin dhe respektimin e dispozitave ligjore që kërkohen për emërimin e një bordi profesional dhe funksional. Shkeljet më të shpeshta lidhen e mosrespektimin e kritereve për pavarësi politike, barazi gjinore apo mosemërim të bordeve të plota ashtu siç kërkohen më ligj.

---

<sup>34</sup> Ligji për Ndërmarrjet Publike, Neni 43 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>





# CILAT JANË PRAKTIKAT NË NDËRMARRJET PUBLIKE NË KOSOVË

Ky hulumtim ka analizuar bordet e ndërmarrjeve publike qendrore, të cilat janë emëruar apo zgjedhur në gjysmën e dytë të vitit 2020 nga Qeveria Hoti, por pa lënë anash disa borde të tjera që janë emëruar gjatë viteve të kaluara dhe të cilat vazhdojnë të udhëheqin me këto ndërmarrje. KDI-ja ka identifikuar shumë raste të politizimit të bordeve dhe parregullsi gjatë emërimit dhe përzgjedhjes së drejtorëve të

bordeve të përhershme dhe atyre të përkohshme. Tutje, janë disa raste kur Qeveria e Kosovës kishte vendosur në krye të ndërmarrjeve publike persona të cilët nuk plotësonin kriterin e pavarësisë dhe mundësisë së konfliktit të interesit, nuk e kishte respektuar procedurën për përzgjedhjen e bordit, e cila është e përcaktuar me ligj apo drejtorët e bordeve nuk i kanë respektuar obligimet e tyre ligjore.

Ndërmarrja Publike Qendrore	Anëtarët e Bordit me lidhje politike	Lidhja politike	Deklarimi i pasurisë së drejtorëve të Bordit	Numri i grave në udhëheqje
Korporata Elektroenergjetike e Kosovës	<b>Musa Misini</b>	<p>Ishte kandidat për deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës në zgjedhjet e parakohshme të vitit 2014<sup>35</sup> dhe ish-kryetar i Komunës së Vitisë.<sup>36</sup></p> <p>Sipas mediave,<sup>37</sup> i njëjti në kohën kur është votuar si anëtar bordi ka qenë në pension, pasi që kishte arritur moshën 67 vjeç</p>	Drejtorët e Bordit të KEK-ut, përveç Fatime Grajcevcit, ende nuk kanë deklaruar pasuritë e tyre. Prej tyre, Petrit Ibraj u emërua me vendim të Qeverisë më 3 gusht 2020 <sup>38</sup> , e katër muaj prej emërimit të tij, ai ende nuk e ka përmbushur këtë detyrim ligjor.	1/4

35 Lista e kandidatëve të subjekteve politike për zgjedhjet e vitit 2014 [https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/04/143\\_2014-Broshura\\_sq-sr-tr.pdf](https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/04/143_2014-Broshura_sq-sr-tr.pdf)  
 Rezultat e kandidatëve <https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/04/3.-Rezultatet-e-t%C3%AB-gjith%C3%AB-kandidat%C3%ABve-2014.pdf>

36 <https://kallxo.com/lajm/anetari-i-ldk-se-emerohet-kryesues-i-bordit-te-kek-ut/>

37 <https://ballkani.info/hoti-e-nxorri-nga-pension-i-musa-misinin-e-ldk-se-per-ta-bere-kryetar-te-bordit-ne-kek/>

38 Vendimi i mbledhjes 19 të Qeverisë <https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/08/Vendimet-nga-mbledhja-e-19-t%C3%AB-e-Qeveris%C3%AB.pdf>





Ndërmarrja Publike Qendrore	Anëtarët e Bordit me lidhje politike	Lidhja politike	Deklarimi i pasurisë së drejtorëve të Bordit	Numri i grave në udhëheqje
Posta e Kosovës	<b>Fadil Aliu</b> <b>Elda Maloku</b> <b>Leonard Shabanaj</b> <b>Ujkan Kameraj</b>	Fadil Aliu ishte kandidat për deputet nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës të vitit 2017. <sup>39</sup>  Elda Maloku figuron aktiviste e Nismës Socialdemokrate. <sup>40</sup>  Në anën tjetër Leonard Shabanaj, i cili është emëruar si kryesues i këtij Bordi, ishte zyrtar në Drejtorinë e Arsimit në komunën e Pejës, në kohën kur kjo komunë qeverisej nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe ishte pjesë e kësaj partie <sup>41</sup> .  Ujkan Kameraj vjen nga Partia Liberale Egjiptiane-PLE, parti kjo e cila është pjesë e koalicionit qeverisës. Po ashtu, Kameraj ishte kandidat për deputet në zgjedhjet e parakohshme qendrore të 2014, nga radhët e kësaj partie. <sup>42</sup>	Asnjëri prej drejtorëve të Bordit nuk kanë deklaruar pasuritë e tyre, edhe pse kishin kaluar 30 ditë prej ditës së emërimit të tyre.	1/4
Infrakos	<b>Brahim Selimaj</b>	Brahim Selimaj, i cili është emëruar kryesues i Bordit, ishte kandidat për deputet nga radhët e LDK-së, në zgjedhjet e parakohshme të vitit 2017 dhe 2019.	Kanë deklaruar të gjithë pasurinë e tyre.	0
Trainkos	<b>Ramiz Rustaj</b>	Ishte kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Klinës në zgjedhjet lokale të vitit 2017 nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës. <sup>43</sup> I njëjti sipas rrjeteve sociale të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kishte aderuar në AAK në vitin 2018. <sup>44</sup>	Asnjëri prej drejtorëve të Bordit nuk kanë deklaruar pasuritë e tyre, edhe pse kishin kaluar 30 ditë prej ditës së emërimit të tyre.	1/3

39 Lista e kandidatëve të subjekteve politike për zgjedhjet e vitit 2017 [https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/02/Broshura\\_Kuvend-i-Kosoves-2017.pdf](https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/02/Broshura_Kuvend-i-Kosoves-2017.pdf)  
Rezultat e kandidatëve <https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/01/3.-Rezultatet-e-t%C3%AB-gjith%C3%AB-kandidat%C3%ABve.pdf>

40 <https://kallxo.com/lajm/aktivistja-e-nismes-socialdemokrate-emerohet-anetare-e-bordit-te-postes-se-kosoves/>

41 <https://kallxo.com/lajm/lidhjet-politike-te-bordit-te-postes-qe-vendosi-per-pagat-e-larta-te-menaxhereve/>

42 Lista e kandidatëve të subjekteve politike për zgjedhjet e vitit 2014 [https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/04/143\\_2014-Broshura\\_sq-sr-tr.pdf](https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/04/143_2014-Broshura_sq-sr-tr.pdf)  
Rezultat e kandidatëve <https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/04/3.-Rezultatet-e-t%C3%AB-gjith%C3%AB-kandidat%C3%ABve-2014.pdf>

43 [https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/02/08\\_343\\_Broshura\\_Kline.pdf](https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/02/08_343_Broshura_Kline.pdf)

44 <https://facebook.com/Aleanca.Official/posts/2388737347834012/>



|||||

Ndërmarrja Publike Qendrore	Anëtarët e Bordit me lidhje politike	Lidhja politike	Deklarimi i pasurisë së drejtoreshë të Bordit	Numri i grave në udhëheqje
Trepca	<b>Esat Peci</b>	Ishte kandidat për Kryetar të Komunës së Mitrovicës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Ai ishte zgjedhur si anëtar i Kuvendit Komunal të Mitrovicës në zgjedhjet lokale të vitit 2017. <sup>45</sup> Peci fillimisht u emërua drejtor i Bordit Mbikëqyrës të Trepçës nga Qeveria Haradinaj në vitin 2018. Me ardhjen në pushtet të Qeverisë Kurti, në shkurt të vitit 2020 ky bord u shkarkua. <sup>46</sup> Disa muaj pas shkarkimit të tij, Esat Peci u emërua përsëri drejtor i Bordit Mbikëqyrës me vendim të Qeverisë Hoti <sup>47</sup> .	Vetëm njëri drejtor (Safet Sadiku) nuk ka deklaruar pasurinë e tij.	0
NPH Ibër-Lepenc	<b>Afërdita Llumina</b>	KDI-ja ka konstatuar se Llumina ishte anëtare e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Sipas rrjeteve sociale të subjektit politik LDK, Llumina përveçse se ishte aktiviste e LDK-së, ajo në vitin 2019 ishte zgjedhur kryesuese e kryesisë së Nëndegës së VII të Degës së I të LDK-së në Kodrën e Trimave. <sup>48</sup>	Vetëm njëri drejtor (Berat Lushtaku) ka deklaruar pasurinë e tij.	2/4
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë	<b>Selatin Retkoceri</b>	Ishte kandidat për deputet nga Lëvizja Vetëvendosje në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2017. <sup>49</sup> Retkoceri ishte gjithashtu kandidat për kryetar të komunës së Lipjanit në zgjedhjet lokale të vitit 2017 i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje. <sup>50</sup> I njëjti në shtatorin e vitit 2019, pasi që ishte emëruar drejtor bordi, kishte kaluar në Partinë Demokratike të Kosovës (PDK). <sup>51</sup>	Tre drejtor bordi nuk kanë deklaruar pasurinë (Selatin Retkoceri, Gazmend Bytyqi dhe Bashkim Krasniqi).	0

45 Lista e kandidateve për kryetar të komunës së Mitrovicës së Jugut të vitit 2017 [https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/02/11\\_200\\_Fletevotimi\\_Mitrovica-e-Jugut\\_Kryetar.pdf](https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/02/11_200_Fletevotimi_Mitrovica-e-Jugut_Kryetar.pdf)

Rezultatet e zgjedhjeve <https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/04/1.pdf>

Rezultatet përfundimtare për kuvendin komunal të zgjedhjeve të vitit 2017 <https://kqz-ks.org/ep-content/uploads/2018/01/2.pdf>

46 Vendimi i Qeverisë për shkarkimin e bordit të Trepçës <https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-4-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf>

47 Vendimi i mbledhje 36 të Qeverisë <https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/10/Vendimet-e-mbledhjes-s%C3%AB-36-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>

48 <https://www.ëëëfacebook.com/1450643445246730/posts/2218779158433151/>

49 [https://kqz-ks.org/wëp-content/uploads/2018/02/Broshura\\_Kuvend-i-Kosoves-2017.pdf](https://kqz-ks.org/wëp-content/uploads/2018/02/Broshura_Kuvend-i-Kosoves-2017.pdf)

50 [https://kqz-ks.org/wëp-content/uploads/2018/02/13\\_200\\_Fletevotimi\\_Lipjan\\_Kryetar.pdf](https://kqz-ks.org/wëp-content/uploads/2018/02/13_200_Fletevotimi_Lipjan_Kryetar.pdf)

51 <https://kallxo.com/lajm/kadri-veseli-e-mirepret-ne-pdk-ish-kryetarin-e-vetevendosjes-ne-lipjan/>

|||||

# MOSRESPEKTIMI I PROCEDURAVE GJATË EMËRIMIT

Një problem tjetër, i cili është vërejtur gjatë kësaj analize është mosrespektimi i procedurave ligjore gjatë emërimit të bordeve të përkohshme. Qeveria Hoti më 15.07.2020 kishte hapur konkurs për emërimin e drejtorëve të Bordeve të Përkohshme të Ndërmarrjeve Publike Qendrore.<sup>52</sup>

Gjatë emërimit të anëtarëve të bordeve të përkohshme, Qeveria, ligjërisht nuk është e obliguar t`i ndjekë procedurat e njëjta sikurse gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të bordit. Në rastet kur Qeveria emëron bordin e përkohshëm, ligji nuk e obligon ta ndjek këtë procedurë.

Sidoqoftë, Qeveria kishte shpallur konkurs për drejtorë të bordeve të këtyre ndërmarrjeve publike dhe më pas kishte shpallur edhe listat e kandidatëve të cilët janë ftuar për intervistë me gojë. Tutje, Qeveria kishte marrë edhe vendim për emërimin e bordeve të përkohshëm të disa prej ndërmarrjeve publike<sup>53</sup>. KDI-ja gjatë analizimit të listave të kandidatëve të ftuar për intervista me gojë dhe drejtorëve të emëruar, ka identifikuar raste kur personat që janë emëruar drejtorë të bordeve mungojnë në listat e personave të ftuar për intervistim. Midis tyre gjendet emri i Musa Misinit, i emëruar kryetar i Bordit të Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës, si dhe emri i Leonard Shabanajt e Elda Malokut, të emëruar drejtorë të Bordit të Postës së Kosovës.

Ndonëse nuk është e obliguar t`i ndjek këto procedura gjatë emërimit, Qeveria ka vepruar konform tyre, për të devijuar pastaj nga procedura të tilla, duke emëruar persona, të cilët nuk ishin pjesë e procedurës së emërimit.



Gjatë emërimit të anëtarëve të bordeve të përkohshme, Qeveria, ligjërisht nuk është e obliguar t`i ndjekë procedurat e njëjta sikurse gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të bordit. **Në rastet kur Qeveria emëron bordin e përkohshëm, ligji nuk e obligon ta ndjek këtë procedurë.**

<sup>52</sup> Konkursi i shpallur nga Qeveria e Kosovës <https://kryeministri-ks.net/dokumente/page/2/?kategoria=konkurse-njoftime-dhe-shpallje&viti=2020#038:viti=2020>  
<sup>53</sup> Vendimet e Qeverisë për emërimin e bordeve të përkohshme <https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/10/Vendimet-e-mbledhjes-s%C3%AB-36-t%C3%AB-t%C3%AB-Beveris%C3%AB.pdf>

[https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/10/Vendimi-i-mbledhjes-s%C3%AB-37-t%C3%AB-Beveris%C3%AB-1.pdf?\\_\\_cf\\_chLjschLtk\\_\\_=1d3210397c69b1e16f0d3ce53e2af14e6da3b7a2-1619688438-0-ASUeDL1vS5vPXditB1s7xxXeshKLChnKl9sZqU3b8AD551sGz8jxë1NFrDYgE4nKgfvëBgJH eUdc3b3kq6lRhMAJj36IZ3XS678ëyn7lpKpm1u-bb6l1ëGn1bn0ctG80UzmK32Se7hP3ljGhëlnj9lxH7vnr9g03MGvVFK0Beg33a1mSjhrSksproZUshBh-JrQ7G\\_RU4vfmLqR85-TFMQANSdda2Pe4h9PvQYD-xh5zVbVCbSloC2A5oe0fv2MrMrR3Zz4d6JxEr5B-feGyl3Q1AN05JmXPRHUsBnëY0XIX8b7UjppqEduJo VNU6NyixhzHDvTxTctosFZxHgMI8YKv1rU8RRzQJHCcepTvhfDykqLBX\\_zcc4ëëi29tKHdo7X57BZ7tNSDj82mmnrC1hmsyl-oYMH\\_U1n0fRxiKJKX-1GL3G-QDTMVQ1A03TSJKXLHObVqRp0zJPRE8ë5fl1BrXcYzjpvKYKg93ëlnrOApM0n5QPmoKj3t7RNOzn8A](https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/10/Vendimi-i-mbledhjes-s%C3%AB-37-t%C3%AB-Beveris%C3%AB-1.pdf?__cf_chLjschLtk__=1d3210397c69b1e16f0d3ce53e2af14e6da3b7a2-1619688438-0-ASUeDL1vS5vPXditB1s7xxXeshKLChnKl9sZqU3b8AD551sGz8jxë1NFrDYgE4nKgfvëBgJH eUdc3b3kq6lRhMAJj36IZ3XS678ëyn7lpKpm1u-bb6l1ëGn1bn0ctG80UzmK32Se7hP3ljGhëlnj9lxH7vnr9g03MGvVFK0Beg33a1mSjhrSksproZUshBh-JrQ7G_RU4vfmLqR85-TFMQANSdda2Pe4h9PvQYD-xh5zVbVCbSloC2A5oe0fv2MrMrR3Zz4d6JxEr5B-feGyl3Q1AN05JmXPRHUsBnëY0XIX8b7UjppqEduJo VNU6NyixhzHDvTxTctosFZxHgMI8YKv1rU8RRzQJHCcepTvhfDykqLBX_zcc4ëëi29tKHdo7X57BZ7tNSDj82mmnrC1hmsyl-oYMH_U1n0fRxiKJKX-1GL3G-QDTMVQ1A03TSJKXLHObVqRp0zJPRE8ë5fl1BrXcYzjpvKYKg93ëlnrOApM0n5QPmoKj3t7RNOzn8A)



# REKOMANDIMET

- Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji për Ndërmarrje Publike me qëllim të rritjes së transparencës dhe mbikëqyrjes së procesit të emërimit dhe përzgjedhjes të anëtarëve të Bordeve nga Komisioni Rekomandues dhe Qeveria e Kosovës në mënyrë që të pengohet politizimi i Bordeve nga përzgjedhja e anëtarëve joprofesional, duke i dhënë mundësinë atyre të paanshëm nga ngjyrimet partiake.
- Të ndryshohet Ligji për Ndërmarrjet Publike, si dhetë kufizohet mosha e drejtorëve të bordeve deri në moshën 65 vjeç.
- Të zbatohet formula që kërkon borde të plota të ndërmarrjeve publike në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike në mënyrë që ato të jenë funksionale dhe vendimmarrëse.
- Të rishikohet kolizioni në mes nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 70 të Ligjit të Punës.
- Të publikohen CV-të dhe biografite të anëtarëve të Bordit në faqet e ndërmarrjeve publike.
- Të respektohet Ligji për Barazinë Gjinore duke i ndërmarrë masat përcaktuara me ligj për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor si në udhëheqje ashtu edhe në segmentet e tjera të funksionimit të NP-ve.
- Agjencia Kundër Korrupsion të sigurojë respektimin e Ligjit për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publik.
- Të respektohen dispozitat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.





Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) / Transparency International Kosova (TIK), beson në një Kosovë ku qeveria, bizneset, shoqëria civile dhe jeta e përditshme e qytetarëve janë të lira nga korrupsioni. KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe luftën kundërkorrupsion përmes promovimit të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Me përkrahjen financiare nga Ministria Federale e Punëve të Jashtme e Gjermanisë



RAPORTO KORRUPSIONIN në numrin pa pagesë

**0800 77777** ose online në

**<https://raporto.kdi-kosova.org>**

